

V E N D I M

Nr.621, datë 25.9.1998

PËR KRIJIMIN E KOMITETIT TË KONSULENCËS DHE TË TRANSPARENCËS PËR PRIVATIZIMIN E SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË TË EKONOMISË

Në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike të dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e komitetit të konsulencës dhe të transparencës, për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë të ekonomisë.

2. Ky komitet ka objekt të veprimtarisë së vet:

- Të vazhdojë funksionet e konsulencës dhe të transparencës së procedurave të vendosura për privatizimin sipas legjislacionit në fuqi.

- Të sigurojë dhe të udhëzojë të gjitha proceset e privatizimit, të parashikuara në strategjinë e privatizimit, të miratuar me ligjin nr.8306, datë 14.3.1998, duke garantuar që procedurat udhëzuese për këto çështje të jenë në zbatim të legjislacionit në fuqi për privatizimin, duke ngritur për këtë qëllim grupe të veçanta pune.

- Të sugjerojë nisma në fushën ligjore, fiskale dhe ekonomike, të nevojshme për të favorizuar suksesin e programit të privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë të ekonomisë shqiptare.

- T’i propozojë Komitetit për Politikën Ekonomike, pranë Këshillit të Ministrave, kalendarin e operacioneve të privatizimit.

3. Komiteti përbëhet nga 13 anëtarë, dy përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, një përfaqësues nga Ministria e Financave, një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, dy përfaqësues nga organet përkatëse, që përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore, të cilët kanë në vartësi dhe gjashtë anëtarë të tjerë, që do të caktohen ndërmjet konsulentëve financiarë, ligjor dhe të marketingut, të seleksionuar në nivel ndërkombëtar nëpërmjet procedurave konkurruese të njohura nga Banka Botërore.

4. Komiteti drejtohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, i cili mund t’ia delegojë këtë detyrë Zëvendësministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

5. Brenda 15 ditëve nga kërkesa e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit, ministritë dhe institucionet e përcaktuara në pikën 3, duhet të dërgojnë propozimet për përfaqësuesit e tyre pranë Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Në rastin kur përfaqësuesi i propozuar nuk merr pjesë në mbledhjet e komitetit, ministri përkatës siguron zëvendësimin e tij në kohën e duhur.

6. Shoqëritë e përfshira në programin e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë, si dhe ministritë e tjera të interesuara, duhet t’i sigurojnë komitetit të gjitha informacionet me natyrë ligjore, financiare, kontabile dhe ekstrakontabile, të nevojshme për zhvillimin e detyrave që i janë ngarkuar këtij komiteti.

7. Anëtarët e komitetit dhe të gjithë personat që marrin pjesë në mbledhjet e tij janë të detyruar të ruajnë sekretin për informacionet e siguruar dhe të mos i përdorin ato për qëllime të tjera, të ndryshme nga ato të veprimtarisë institucionale të këtij komiteti.

8. Organizimi dhe funksionimi i komitetit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe i Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

